



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. **816/10**Prot.

Tiranë, më **30.12.2016**

V E N D I M

Nr. **172** Datë **30.12.2016**

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
“AGJENCINË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS KANALIZIME” TIRANË
MBI “ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË
VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE”
PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI I RRJETIT HIDRIK NË TIRANË”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në subjektin “Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime” Tiranë për projektin “Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë”, për periudhën 01.01.2011 deri 31.08.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, dërguar me shkresën nr. 55/4, datë 30.05.2011, rezultoi se rekomandimet janë zbatuar pjesërisht. Rekomandimi për 1 masë për shpërblim dëmi, rezulton se është realizuar plotësisht dhe nga 3 masa organizative të rekomanduara nga KLSH, nuk është realizuar asnjë masë.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit, të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të porealizuara nga auditimi i mëparshëm i KLSH, me qëllim realizimin e tre masave organizative.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Nga kontrolli i dokumentacionit të vënë në dispozicion për disbursimin financiar për kontratat objekt auditimi që i përkasin komponentit të III-të, të projektit “Rehabilitimi i rrjetit hidrik, Tiranë” u konstatua se në 16 praktika të dibursimit të pagesave, Autoriteti Kontraktor nuk ka zbatuar kushtin për afatin e pagesës prej 28 ditësh nga momenti i certifikimit të punimeve, në kundërshtim me Shtojcën 1 të kontratës, veprim ky i cili do të favorizonte operatorin ekonomik në rast ankimumi nga ana e tij (edhe pse në kontratë nuk ka një përcaktim në përqindje të penaltetit për këto vonesa).

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit të marrë masa që në vazhdimësi për shumën e mbetur të kredisë të projektit “Rehabilitimi i rrjetit hidrik të Tiranës” të repsektojë afatet e pagesave të përcaktuara në kontratat e nënshkruara si palë nga ana e saj, duke mos u lënë operatorëve ekonomikë në të ardhmen hapësira për lindjen e së drejtës për përfitimin e kamatvonesave.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i pagesave të kryera nga Autoriteti Kontraktor u konstatua se pagesa nr. 4 për punimet e realizuara në kontratën me objekt “Përmirësimi i performancës së depove të trajtimit të ujit në Bovillë” është bërë me datë 23.05.2011, ndërkohë që certifikimi i punimeve nga supervizori i punimeve është bërë në datën 10.11.2011 ose afërsisht 6 muaj më vonë. Në këtë rast kemi të bëjmë me një parapagim të pajustificuar, veprim i cili është në kundërshtim me shtojcën nr.1 të kontratës, ku thuhet se disbursimi për pagesat e situacioneve duhet të kryhet pasi të jenë certifikuar më parë nga mbikëqyrësi.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit të marrë masa që në vazhdimësi për shumën e mbetur të kredisë të projektit “Rehabilitimi i rrjetit hidrik të Tiranës” të mos kryejë asnjë disbursim pa marrë paraprakisht certifikimin e punimeve nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, si e vetmja garanci kontraktuale për zbatimin e projekteve.

Në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e veprave të dorëzuara rezulton se, nga përfituesi i këtij projekti [REDACTED], nuk janë marrë në dorëzim veprat e përfunduara si dhe makineritë dhe pajisjet. Pas përfundimit të kontratave (Vitet 2011-2012) që i përkasin periudhës së auditimit, nga DPUK (Sot, AKUK) është bërë punë e pamjaftueshme për dorëzimin e tyre. Për këtë problematikë, AKUK nuk i ndjekur shkallët administrative, duke mos i drejtuar asnjë shkresë [REDACTED], organ i cili ka në varësi [REDACTED], ku të trajtohet ky mosrakordim institucional si dhe të kërkohet nxjerrja e përgjegjësive administrative. Mos rregjistrimi kontabël i aktiveve të projektit bën që amortizimi i pajisjeve të mbetet i pa pasqyruar gjatë kësaj periudhe.

-Nga auditimi fizik në magazinat e [REDACTED], u konstatua se pjesët rezervë të projektit janë lënë në ambjentet e magazinës pa u bërë hyrje, pa u marrë në dorëzim nga përgjegjësi i magazinës dhe pa asnjë dokumentacion dëshmuës. Nuk ka asnjë dokument ku të trajtohet se si janë apo kush i ka sjellë këto materiale, si dhe kush i ka pranuar në magazinë pa kryer veprimet ligjore.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit pranë [REDACTED] në bashkëpunim me [REDACTED], si përfitues përfundimtar i projektit, të marrin masa për marrjen në dorëzim të pjesëve rezervë të projektit dhe të bëjnë kontabilizimin e veprave të përfunduara, të makinerive dhe pajisjeve të projektit.

Për sa më sipër të njoftohet [REDACTED], si organi që ka në varësi [REDACTED], ku të kërkohet nxjerrja e përgjegjësive individuale dhe institucionale dhe marrja e masave administrative.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në objekt i realizimit të punimeve të kontratës “Punime për të Përmirësuar Performancën e Impiantit të Bovillës” u konstatua se një pjesë e pajisjeve të cilat janë konsumuar ose prishur pas përfundimit të punimeve në vitin 2011 janë zëvendësuar nga ana e [REDACTED]. Në kushtet speciale të kontratës (pika 7.3)

thuhet se kontraktori duhet t'i zëvendësojë këto pajisje brenda 5 viteve nga përfundimi i punimeve.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e [.....], për administrimin e impiantit të Bovillës në këto 5 vite janë shpenzuar 9,578,389 lekë. Duke qënë se këto pajisje nuk janë siguruar nga kontraktori, pasi kjo gjë nuk i është kërkuar as nga AKUK, as nga UKT, ky shpenzim ka prekur në mënyrë të drejtëpërdrejtë buxhetin e UKT Sh.A.

Për këtë rekomandojmë:

AKUK, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës, së bashku me [.....], për analizimin e shumës 9,578,389 lekë si investim i kryer nga [.....] në impiantin e Bovillës, duke e vlerësuar situatën bazuar në pikën 7.3 të kushteve speciale të kontratës dhe fizikisht për sa i përket pajisjeve të zëvendësuara. Gjithashtu të marren masa që në të ardhmen për pjesën e mbetur të kredisë, njësia e zbatimit të projektit të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë punën me [.....] si përfitues përfundimtar i projektit, për riparimet dhe zëvendësimet që mund të bëhen në veprat e rrjetit hidrik të Tiranës, sipas kushteve specifike të përcaktuara në kontratë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

Në 6 raste, nga auditimi i zbatimit të procedrave të prokurimit dhe i zbatimit të kontratave, u konstatuan se:

-Dosjet e prokurimit dhe të zbatimit të kontratave janë të painventarizuar dhe me praktika jo të plota, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Urdhrin Nr. 93, datë 28.01.2009 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime”, pika 4.10, pika 4.13, nën-pika 10 sipas të cilës, “Të gjithë punonjësit e AKUK, janë të detyruar të depozitojnë në arshivën e institucionit praktika të vlerësuara të përfunduara nga drejtuesit e institucionit”.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projekteve Hidrike, Pranë AKUK të marrë masa që të plotësojë me dokumentacion të plotë tekniko-ligjor të gjitha dosjet që i përkasin projektit “Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë” dhe të inventarizojë dosjet e prokurimit publik dhe dosjet e zbatimit të kontratave të përfunduara të projektit, në zbatim të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Urdhërit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime”. Gjithashtu për shumën e mbetur të projektit, nga Njësia e Zbatimit të Projektit në vazhdimësi të merren masa për inventarizimin dhe arshivimin e dosjeve të përfunduara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi në objekt i depos së ujit në Qytetin e Nxënësit për kontratën “*Prodhimi i ujit dhe rehabilitimi i depove*” u konstatua se: Depoja në pjesën veriore në 2 vende në lartësinë rreth 150 cm nga toka kishte rrjedhje uji (pa ndërprerje) dhe plasaritje të mureve nga jashtë. Bazuar në raport progresin e periudhës qershor 2011 deri gusht 2011, faqe 5, të hartuar nga mbikëqyrësi i punimeve, punimet e hidroizolimit për muret e brendshme të depos se ujit janë realizuar në masën 50 %. Gjithashtu në dokumentin “Çertifikatë pjesore e përfundimit të punimeve (Partial completion certificate)” sipas kushteve të përgjithshme të kontratës, kapitulli 25.3, punimet e hidroizolimit për muret e brendshme të depos se ujit janë realizuar në masën 50 %. Nga auditimi u konstatua se për pjesën e pahidroizoluar të depos, materialet janë bërë hyrje në magazinën e Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, por nuk është marrë asnjë masë për kryerjen e punimeve për hidroizolim të depos së ujit.

Për këtë rekomandojmë:

AKUK t’i kërkojë [REDAKTUAR] si përfitues përfundimtar i projektit, të ngrejë një grup pune dhe të marrin masa për hidroizolim të plotë të depos së ujit në Qytetin e Nxënësit, në përputhje me kërkesat e projektit të zbatimit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratave për punë publike konstatohet se, kontratat janë hartuar në gjuhën Angleze. Vendosja e gjuhës angleze si gjuhë e vetme në përgatitjen e dokumentacionit teknik të zbatimit, ka sjell si pasojë plotësimin jo korrekt të propozimeve për ndryshime në projektin e zbatimit dhe jo në zbatim të anekseve të kontratave.

Për këtë rekomandojmë:

AKUK të marrë masa, për të gjitha kontratat e punëve publike, hartimi i të cilave bazohet në manualin e kontratave të Bankës Botërore, të bëhet përkthimi zyrtar, bazuar në nenin 14 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në Ligjin Nr. 8371 datë 09.07.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, neni 12, pasi kantata klasifikohet dokument zyrtar.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi:

Gjatë periudhës së garancisë së defekteve (*Korrik 2011 deri korrik 2012*) për kontratat “*Prodhimi i ujit dhe rehabilitimi i veprave*” dhe “*Punime për të përmirësuar performancën e impiantit të Bovillës*” nga ana e kontraktorit nuk është mbajtur certifikatë përfundimtare e përfundimit të punimeve sipas kontratës (*Forma 7, Completion certificate*) në kundërshtim me pikën 24 të kushteve të përgjithshme të kontratës.

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Zbatimit të Projektit, të marrë masa që në vazhdimësi t'i kërkojë kontratorëve të realizojnë çertifikatën përfundimtare të përfundimit të punimeve sipas kontratës së lidhur.

Në vazhdimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjatë auditimit është konstatuar dëm ekonomik me vlerë **575,448 Euro**. Në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Prodhimi i ujit dhe rehabilitimi i depove*” u konstatuan se është financuar operatori ekonomik “**.....**” S.p.a me drejtues ligjor Z. A. G. për zëra punimesh të pakryera, për diferenca në zëra dhe volume duke përfituar padrejtësisht për punë të pakryer në **shumën 222,816 Euro duke shkaktuar një dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit.

Për këtë rekomandojmë:

*AKUK të marrë masa, që t'i kërkojë operatorit ekonomik “**.....**” S.p.a duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyimit për arkëtimin e shumës **222,816 Euro**, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.*

Deri me datë 31.01.2017

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Punime për të Përmirësuar Performancën e Impiantit të Bovillës*” u konstatuan se është financuar operatori ekonomik “**.....**” S.p.a me drejtues ligjor z. A. G. për zëra punimesh të pakryera, për diferenca në zëra dhe volume, si dhe mos argumentim për pajisje dhe makineri me faturë blerje, duke përfituar padrejtësisht për punë të pakryer në **shumën 217,370 Euro duke shkaktuar një dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit.

Për këtë rekomandojmë:

*AKUK të marrë masa, që t'i kërkojë operatorit ekonomik “**.....**” S.p.a duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyimit për arkëtimin e shumës **217,370 Euro**, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.*

Deri me datë 31.01.2017

3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Shërbim konsulence dhe mbikëqyrje punimesh” u konstatuan se shoqëria “.....” S.p.a, me përfaqësues z. L. C. ka realizuar pjesërisht kontratën e nënshkruar, duke mbikëqyrë realizimin e punimeve të dy kontratave (“Punime për prodhimin e ujit dhe rehabilitimi i veprave”, me vlerë 3,852,155.38 € dhe “Punime për të përmirësuar performancën e impiantit të Bovillës” me vlerë 903,761.03 €), ndërkohë që sipas skedulit të mbikëqyrjes së supervizionit të objekteve të pasqyruara në kontratë, do të mbikëqyrëshin 4 kontrata (1. Riparimet ne rrjetin e furnizimit me uje dhe kanalizimeve, 2. Rehabilitimi i tubacionit kryesor Shën Mëri-Qaf Mollë, 3. Punime për prodhimin e ujit dhe rehabilitimi i veprave dhe 4. Punime për të përmirësuar performancën e impiantit të Bovillës) nga kjo shoqëri. Sa më sipër kryerja e punës vetëm për dy kontrata (nga katër), shoqëria “.....” S.p.a., **ka përfituar padrejtësisht shumën 135,262 Euro** [(435,162 € vlerë e disbursuar) – 299,900 € (punë e kryer për 2 kontrata)] për punë të pa kryer, veprim ky në kundërshtim me termat e përcaktuara në kontratën e konsulentit, aneksi IV “Përshkrimi i projektit”, Tabela 1.

Për këtë rekomandojmë:

*AKUK të marrë masa, që t'i kërkojë operatorit ekonomik “.....” S.p.a duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës **135,262 Euro**, të cilën e ka përfituar tepër për punë të pakryera për (1. Riparimet ne rrjetin e furnizimit me uje dhe kanalizimeve dhe 2. Rehabilitimi i tubacionit kryesor Shën Mëri-Qaf Mollë).*

Deri me datë 31.01.2017

C. SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFICËNCËS DHE EFEKTIVITETIT.

Gjatë auditimit është konstatuar përdorim pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve me vlerë **407,147.85 Euro**, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i realizimit të punimeve të kontratës “*Prodhimi i ujit dhe rehabilitimi i depove*” nënobjekti stacioni i pompimit Qafë Mollë u konstatua se:

Sipas projektit të zbatimit ishte parashikuar ndërtimi i një nënstacioni të ri elektrik, ndërkohë që nga, i është kërkuar shoqërisë zbatuese “.....” të bëjë pezullimin e ndërtimit të nënstacionit të ri elektrik dhe të realizojë blerjen e 7 transformatorëve elektrikë me qëllim mbrojtjen e pompave të reja. Shoqëria “.....” me datë 09.03.2012 dhe nr. prot. 300/2012 i drejtohet me shkresë mbikëqyrësit të punimeve dhe koordinatorit të njësisë së zbatimit të projektit për

aprovimin e blerjes së 7 transformatorëve elektrikë. Në këto kushte në skedulin nr. 5, të situacionit nr. 11, shtohet zëri i ri nr. 12 për blerjen e transformatorëve në shumën 111,303 Euro për 7 transformatorë elektrikë. Nga auditimi në objekt u konstatua se **transformatorët jo vetëm nuk janë vendosur në punë, por mbahen në ambientet e jashtme të stacionit të pompimit**. Nga vendosja në punë e pompave të reja të ujit, të pa mbrojtura me panele elektrike dhe transformatorët elektrikë, ka ndodhur dëmtimi dhe shkatërrimi i pompave të ujit duke e bërë të paefektshëm blerjen e transformatorëve.

Nisur nga fakti se stacioni i pompimit në Qafë Mollë, aktualisht punon me pompat e vjetra të amortizuara, me konsum të lartë të energjie elektrike, ndërkohë që pompat e reja të blera me kërkesë të do të siguronin rritjen e prurjes së ujit dhe kursim të energjisë elektrike janë të dëmtuara dhe në gjendje stoku, ky veprim nuk i ka shërbyer propozimit të bërë nga

Blerja e shtatë transformatorëve elektrikë me qëllim mbrojtjen e pompave centrifugale horizontale të ujit (ku aktualisht nuk janë në gjendje pune) rezulton shpenzim i panevojshëm dhe i pa argumentuar teknikisht nga, dhe ka sjellë si pasojë **përdorimin pa efektivitet, pa ekonomikitet dhe pa efikasitet të fondeve publike me vlerë 407,147 Euro.**

Për këtë rekomandojmë:

*AKUK-ja të bashkëpunojë dhe të koordinojë punën me si përfitues përfundimtar i projektit “Prodhimi i ujit dhe rehabilitimi i depove”, që problematika e konstatuar për **përdorimin pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike me vlerë 407,147 Euro**, në mungesë të dokumentacionit argumentues si (kartelat e punës së pompave, hyrja dhe dalja e pompave dhe transformatorëve nga magazina e, urdhëri nga titullari për transportin dhe montimin e tyre në stacionin Qafë Mollë, urdhëri për çmontimin e pompave të vjetra dhe hyrjen në magazinë si dhe veprimet e kundërta, testet e kryera për pompat në regjim normal pune, etj..) t’i nënshtrohen një analize të thelle nga Auditi i Brendshëm i dhe të dalin përgjegjësitë individuale për pompat e dëmtuara si dhe mos vënien në punë të transformatorëve elektrikë.*

Të merren masa për riparimin e pompave të dëmtuara në stacionin e pompimit Qafë Mollë dhe të realizohet vendosja e tyre në pune.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE.

Bazuar në Udhëzuesin për Konsulencë, sipas financimeve të Bankës Borërore, i kërkojmë Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizime:

Të shpallë të papranueshëm për lidhjen e kontratave për shërbime konsulence Shoqërinë “.....” dhe për punime civile kompaninë “.....” si dhe të marrë masa për njoftimin e Bankës Botërore mbi performancën e dobët të këtyre kompanive gjatë zbatimit të kontratave të ndërtimit me objekt “Prodhimi i ujit dhe

rehabilitimi i veprave” dhe *“Punime për të përmirësuar performancën e impiantit të Bovillës”*, për arsye se zbatimi i kontratës së supervizionit dhe zbatimi i kontratave të punimeve civile, është shoqëruar me shkelje dhe mangësi si më poshtë:

- **Shoqëria “.....”** si konsulent dhe mbikëqyrës i punimeve në zbatimin e kontratës *“Shërbimeve të konsulencës dhe mbikëqyrje e punimeve”*, ka realizuar pjesërisht kontratën e nënshkruar me datë 10.08.2006, duke realizuar ndjekjen e dy kontratave (*“Punime për prodhimin e ujit dhe rehabilitimi i veprave”* me vlerë 3,852,155.38 € dhe *“Punime për të përmirësuar performancën e impiantit të Bovillës”* me vlerë 903,761.03 Euro) dhe nuk ka ndjekur punimet për dy kontratat e tjera sipas skedulit të mbikëqyrjes së supervizionit të objekteve të cilat do mbikëqyreshin nga kjo shoqëri. Dy objektet nuk janë ndërtuar fare dhe konkretisht (1. Riparimet në rrjetin e furnizimit me uje dhe kanalizimeve dhe 2. Rehabilitimi i tubacionit kryesor Shën Mëri-Qaf Mollë) sepse aktualisht janë parashikuar për tenderim, sipas *“Memorandum mirëkuptimi për përdorimin e fondit të mbetur nga kredia e butë AID nr. 6345”*. Shoqëria mbikëqyrëse e punimeve *“.....”* me përfaqësues z. L.C. ka realizuar kontratën për dy kontrata dhe jo për katër kontrata duke përfituar padrejtësisht shumë **135,262 Euro** [(435,162 € vlerë e disbursuar) – 299,900 € (punë e kryer për 2 kontrata)] për punë të pa kryer.

- **Shoqërisë zbatuese “.....”** në zbatimin e punimeve për kontratën *“Prodhimi i ujit dhe rehabilitimi i veprave”* ka shkaktuar dëm ekonomik në shumë **222,816 Euro**, për diferenca në zëra punimesh dhe volume të përealizuara, në kundërshtim me kontratën (Adendumi nr. 1) e nënshkruar me datë 04.02.2009 ndërmjet Autoritetit Kontraktor *“Ministria së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit”* dhe shoqërisë zbatuese *“.....”*.

- **Shoqërisë zbatuese “.....”** në zbatimin e punimeve për kontratën *“Punime për të përmirësuar performancën e impiantit të Bovillës”* ka shkaktuar dëm ekonomik në shumë **217,370 Euro**, për diferenca në zëra punimesh dhe volume të përealizuara, në kundërshtim me kontratën (Adendumi nr. 1) e nënshkruar me datë 26.12.2007 ndërmjet Autoritetit Kontraktor *“Ministria së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit”* dhe shoqërisë zbatuese *“.....”*.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE.

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Komëtare të Ujësjetës Kanalizime të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

“Largim nga puna” për:

1. Z. A.M. me detyrë Koordinator i Njesisë së Zbatimit të Projektit “Përmirësimi i Rrjetit Hidrik në Tiranë” nga data 13.11.2013 e në vazhdim, sepse:

- Njësia e Zbatimit të Projektit “*Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë*”, nuk disponon dosjen e plotë të zbatimit për kontratën “*Prodhimi i ujit dhe rehabilitimi i depove*” si dhe nuk ka bërë inventarizimin e dokumentacionit sipas Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 për Arkivat dhe Urdhërin Nr. 93, datë 28.01.2009 “*Për miratimin e rregullores së funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime (Sot, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime)*”.

- Njësia e Zbatimit të Projektit “*Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë*”, nuk disponon dosjen e plotë të zbatimit për kontratën “*Shërbime të konsulencës dhe mbikëqyrje e punimeve*” si dhe nuk ka bërë inventarizimin e dokumentacionit sipas Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 për Arkivat dhe Urdhërin Nr. 93, datë 28.01.2009 “*Për miratimin e rregullores së funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime (Sot, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime)*”.

- Njësia e Zbatimit të Projektit “*Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë*”, nuk disponon dosjen e plotë të zbatimit për kontratën “*Punime për të përmirësuar performancën e impiantit të Bovillës*” si dhe nuk ka bërë inventarizimin e dokumentacionit sipas Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 për Arkivat dhe Urdhërin Nr. 93, datë 28.01.2009 “*Për miratimin e rregullores së funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime (Sot, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime)*”.

- Njësia e Zbatimit të Projektit “*Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë*”, nuk disponon dosjet e plota të tenderit “*Përzgjedhja e konsulentëve për punët e supervizionit*”, të tenderit “*Punime për konsolidimin e planit rrëshqitës në afërsi të impiantit të trajtimit të ujit të pijshëm në Bovillë*”, të tenderit “*Prokurimi i pajisjeve dhe materialeve për riparimin e sistemit të ujit dhe kanalizimeve të Tiranës*” si dhe nuk ka bërë inventarizimin e dokumentacionit sipas Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 për Arkivat dhe Urdhërin Nr. 93, datë 28.01.2009 “*Për miratimin e rregullores së funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime (Sot, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime)*”.

Shënim 1:

Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi për ish-Drejtorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime (Sot, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime) z. T.Z., z. E.H., për ish-Drejtorin e Projekteve të Huaja, z. A.K., për ish-Drejtorin e Njesisë së Zbatimit të Projektit, z. P.K., për të cilët do të rekomandonim masë disiplinore nga “*Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna*” deri në “*Largim nga puna*”, por meqenëse këta persona janë larguar nga detyra që kanë mbajtur për periudhën nga viti 2007 deri në 2013 në Agjencinë Komëtare të Ujësjellës Kanalizime Tiranë, masat disiplinore konsiderohen të ezauruara.

Shënim 2:

Shoqëria mbikëqyrëse “.....” Itali, me përfaqësues Z. L.C. me datë 09.12.2016, dhe protokolluar në KLSH me nr. 816/6 prot., datë 13.12.2016, ka kërkuar nga KLSH-ja një version në gjuhën angleze, të Projekt Raporti të Auditimit të lënë në AKUK për projektin “Rehabilitimi i rrjetit hidrik në Tiranë” me pretendimin se Projekt Raporti i Auditimit i është dërguan në gjuhën shqipe.

Në vijim Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën me nr. 816/7 prot, datë 17.12.2016, i është kthyer përgjigje Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës si dhe Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizime , duke sqaron se KLSH bazuar në ligjin organik nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” dhe standardeve INTOSAI, auditon përputhshmërinë, rregullshmërinë e aktivitetit financiar të enteve publike dhe korrespondencën vetëm me këto institucione. Meqenëse gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është gjuha shqipe, në këto kushte kërkesën e konsiderojmë jashtë fushës sonë të veprimit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R